



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME



AA.nr.134/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami kryetar, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Delushe Halimi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 28 dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP. A.nr.41/2025, të datës 26.12.2025, në seancën e mbajtur me datë, 31.12.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pathemeltë ankesa e subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.A.nr.41/2025, të datës 26.12.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.A.nr.41/2025, të datës 26.12.2025, është vendosur: I. Pranohen si të bazuara ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ZP.Anr.41/2025, ZP.Anr.43/2025, ZP.Anr.45/2025, të datës 25.12.2025. II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtë mijë) euro. III. Detyrohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me nenin 36 të Ligjit Nr.



08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, ndërsa të anulojë vendimin ZP.A.nr.41/2025, të datës 26.12.2025.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e subjektit politik ankues, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.A.nr.41/2025, të datës 26.12.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me datë 25.12.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ZP.Anr.41/2025, ZP.Anr.43/2025, ZP.Anr.45/2025, ku në ankesën ZP.Anr.41/2025 theksohet se LDK, përmes aktivistëve të saj, ka vërejtur dy (2) video të kandidatëve për deputetë të LVV-së, Arbërie Nagavci dhe Hysen Durmishi, ku në rastin e parë znj. Nagavci, për qëllime të fushatës zgjedhore, ka përdorur zyrën e saj si ministre në detyrë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kurse në rastin e dytë z. Durmishi, për qëllime të fushatës zgjedhore, ka përdorur pasuri publike, në këtë rast urën në Mitrovicë, për të përfutur poena zgjedhorë, në të cilat kemi të bëjmë me shkelje të nenit 36 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 7 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, si dhe nenit 7 paragrafi 2, nënparagrafët 2.4 dhe 2.7 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Parashtuesi i ankesës i ka bashkëngjitur, në cilësinë e provës, një CD dhe foto për shkeljen e pretenduar.

Në ankesën ZP.Anr.43/2025 theksohet se LDK, përmes aktivistëve të saj, ka vërejtur një postim të faqes zyrtare të Lëvizjes Vetëvendosje në rrjetin social Facebook, e cila promovon punët e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës me logon e partisë të vendosur në foto, si dhe me foto anash të numrit të partisë në këto zgjedhje, duke shkelur kështu dispozitat ligjore, respektivisht nenin 7 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, vendosja e materialit zgjedhor në mënyrë vizuale përmes rrjetit social Facebook dhe bërja e fushatës zgjedhore përmes përdorimit të objekteve publike, në këtë rast QKUK-së. Ankesës i ka bashkëngjitur, në cilësinë e provës, foto.



Në ankesën ZP.Anr.45/2025 theksohet se LDK, përmes aktivistëve të saj, ka vërejtur një postim me shkrim në rrjetin social Facebook të asamblistës së VV-së në Kuvendin Komunal të Prishtinës, si dhe foto ku shihen kandidatët për deputetë nga radhët e VV-së, Arben Vitia, Albulena Haxhiu dhe Hajrulla Çeko, me ç'rast kemi të bëjmë me shkelje të nenit 36 paragrafi 1 të LZP-së, sepse Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është pronë shtetërore e Republikës së Kosovës, më saktësisht pronë publike e dhënë me koncesion për menaxhim, dhe kështoj për përfitime zgjedhore dhe të fushatës është përdorur kjo pasuri publike, veprim ky i ndaluar dhe i ndëshkueshëm. Parashtruesi i ankesës ka bashkëngjitur ankesës foto në cilësinë e provës.


Në përgjigjen në ankesat e datës 26.12.2025 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) theksohet se, për rastin ZP.Anr.41/2025, pretendimet e ankuesit bazohen në interpretimin se komunikimi publik për punën institucionale dhe pjesëmarrja në ngjarje zyrtare gjatë ushtrimit të funksionit publik përbëjnë aktivitet të ndaluar zgjedhor. Një interpretim i tillë nuk gjen mbështetje as në gjendjen faktike të rasteve konkrete dhe as në kuadrin ligjor që rregullon fushatën zgjedhore. Tutje, në përgjigje theksohet se nga analiza e përmbajtjes së videos e cila është paraqitur si provë në ankesën ndaj Arbërie Nagavcit, rezulton se bëhet fjalë për komunikim përmes të cilit informohet publiku mbi të arriturat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, pa thirrje për votim, pa promovim të subjektit politik dhe pa përdorim të gjuhës apo simboleve që synojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të vullnetit zgjedhor të qytetarëve. Në këto rrethana, komunikimi në fjalë përbën informim të lejuar për punën e institucionit dhe nuk mund të cilësohet si aktivitet fushate në kuptim të legjislacionit zgjedhor. Po ashtu, në përgjigje theksohet se sa i përket videos ku paraqitet ministri Hysen Durmishi gjatë ceremonisë së hapjes së urës për këmbësorë në veri, konstatohet se ngjarja në fjalë është zhvilluar si pjesë e ushtrimit të rregullt të funksionit publik dhe realizimit të një projekti institucional. Ceremonia nuk është organizuar me qëllim elektoral dhe as nuk rezulton të jetë pjesë e ndonjë aktiviteti të strukturuar fushate. Shfrytëzimi i mëvonshëm i pamjeve nga kjo ngjarje për informim publik nuk e ndryshon natyrën e aktivitetit fillestar dhe nuk e shndërron atë në veprim zgjedhor të ndaluar, përderisa mungon elementi thelbësor i shfrytëzimit të pasurisë publike. Interpretimi i zgjeruar i propozuar nga ankuesi, sipas të cilit çdo komunikim institucional apo çdo paraqitje publike e një zyrtari gjatë ushtrimit të mandatit do të konsiderohej shkelje zgjedhore, do të krijonte një standard jo proporcional dhe të pajustifikuar të ndalimeve, i cili nuk buron nga ligji. Dispozitat zgjedhore synojnë të ndalojnë shfrytëzimin e funksionit dhe të pasurisë publike për fushatë elektorale, e jo ushtrimin normal të detyrave shtetërore dhe informimin e publikut për punën e institucioneve. Në mungesë të provave



që do të dëshmonin se veprimet e përshkruara janë ndërmarrë me qëllim elektoral, rezulton se ankesa në fjalë është e pabazuar si në aspektin faktik, ashtu edhe në atë juridik.

Në përgjigje në ankesë për rastin ZP.Anr.43/2025, theksohet se ankesa në fjalë është e paqartë në aspektin juridik dhe faktik. Nga përmbajtja e saj nuk rezulton qartë se cili është objekti konkret i shkeljes së pretenduar, përkatësisht nëse ankesa ka të bëjë me vetë publikimin e postimit në rrjetin social Facebook, apo me zhvillimin e ndonjë aktiviteti elektoral në hapësirat e QKUK-së. Kjo mungesë e bën të vështirë ushtrimin efektiv të së drejtës për përgjigje në ankesë dhe përbën mangësi procedurale thelbësore. Në aspektin juridik, ankesa i referohet nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 2.1, pa identifikuar qartë aktin normativ përkatës dhe pa respektuar strukturën normative të dispozitave ligjore dhe nënligjore. Për rrjedhojë, baza juridike e pretenduar është e paidentifikueshme dhe nuk përmbush standardin minimal të saktësisë dhe qartësisë që kërkohet në procedurat para PZAP-it. Praktika e konsoliduar e Panelit kërkon që parashtuesi të identifikojë në mënyrë të qartë dhe të saktë dispozitën ligjore për të cilën pretendon se është shkelur, gjë që në këtë rast mungon. Sa i përket provës së bashkëngjitur në ankesë, e cila konsiston në një postim në faqen zyrtare të Lëvizjes Vetëvendosje! në rrjetin social Facebook, theksohet se e njëjta nuk dëshmon ekzistencën e ndonjë shkeljeje të legjislacionit zgjedhor. Nga përmbajtja e postimit rezulton se bëhet fjalë për një njoftim informues lidhur me ofrimin e një shërbimi të ri shëndetësor në QKUK, pa thirrje për votë, pa slogan zgjedhor, pa promovim të kandidatëve dhe pa përdorim të elementeve tipike të fushatës zgjedhore. Po ashtu, fotografia e bashkëngjitur nuk dëshmon vendosjen e materialeve zgjedhore, organizimin e ndonjë aktiviteti elektoral apo prezencën fizike të subjektit politik në hapësirat e institucionit publik në fjalë. Në këtë kontekst, theksohet se publikimi i një përmbajtjeje në rrjetet sociale, në mungesë të provave se ka pasur aktivitet elektoral apo përdorim të drejtpërdrejtë të objektit publik për fushatë zgjedhore, nuk mund të konsiderohet shkelje e ndalimeve të parapara nga legjislacioni zgjedhor. Ankesa nuk arrin të provojë asnjë element faktik që do të mbështeste pretendimin për përdorim të paautorizuar të hapësirave publike.

Në përgjigje në ankesë për rastin ZP.Anr.45/2025, theksohet se prania fizike e kandidatëve në një hapësirë me qasje publike dhe publikimi i një fotografie nuk përbën vetvetiu aktivitet zgjedhor të ndaluar dhe as shfrytëzim të pasurisë publike në kuptim të nenit 36 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është hapësirë me qasje të përgjithshme, e përdorur çdo ditë nga qytetarë, përfaqësues institucionalë dhe persona privatë, pa kufizim të natyrës politike. Në rastin konkret nuk është dëshmuar se është përdorur ndonjë resurs institucional i aeroportit për qëllime fushate, se është ndërhyrë në funksionimin e tij, apo se është



realizuar ndonjë përfitim material ose organizativ për subjektin politik. Për rrjedhojë, mungon elementi thelbësor i përdorimit funksional dhe institucional të pasurisë publike për qëllime elektorale, i cili është kusht i domosdoshëm për konstatimin e shkeljes së pretenduar. Interpretimi i gjerë i bërë nga ankuesi, sipas të cilit çdo prani apo publikim në hapësira publike do të konsiderohej shkelje zgjedhore, do të binte ndesh me parimet themelore të lirisë së shprehjes dhe do të krijonte një standard jo proporcional të ndalimeve, të paparashikuar nga ligji. Dispozitat ligjore synojnë të ndalojnë shfrytëzimin e pasurisë publike në kuptimin e përdorimit të saj institucional për qëllime fushate, e jo praninë fizike apo shprehjen personale të individëve në hapësira publike, theksohet në përgjigje.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.41/2025 dhe ZP.Anr.43/2025, si dhe ZP.Anr.45/2025, të datës 25.12.2025, dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, evidentuar nën shenjën e përbashkët ZP.Anr.41/2025.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë dhe provat e nxjerra nga PZAP-i sipas nenit 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, vëren se ankesat janë të bazuara.

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesa, ka konstatuar se nga provat materiale të bashkëngjitura në ankesat e subjektit politik LDK, ZP.Anr.41/2025, ZP.Anr.43/2025 dhe ZP.Anr.45/2025, si dhe nga shkresat e tjera të lëndës, rezulton se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), përkatësisht kandidatët për deputetë Arbërie Nagavci, Hysen Durmishi, Arben Vitia, Albulena Haxhiu dhe Hajrulla Çeko, kanë shfrytëzuar institucionet publike për promovim elektoral gjatë fushatës zgjedhore. Konkretisht, znj. Nagavci ka përdorur zyrën e saj si ministere në detyrë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Durmishi ka përdorur pasuri publike, konkretisht urën në Mitrovicë, ndërsa z. Vitia, znj. Haxhiu dhe z. Çeko kanë përdorur Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, si dhe në faqen zyrtare të këtij subjekti janë promovuar aktivitete në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Paneli, konform nenit 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin përcaktohet se: "Paneli, para se të vendosë lidhur me ankesën, mund të kryejë hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme", ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesave dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në llogarinë e rrjetit social Facebook, PZAP-i ka vërtetuar faktin se




subjekti politik, përkatësisht kandidatët e tij, përmes postimeve të publikuara, për qëllime të fushatës zgjedhore kanë përdorur resurset publike, si dhe kanë promovuar punët e institucionit publik, rrjedhimisht kanë shfaqur logon dhe numrin zgjedhor të subjektit politik.

Gjithashtu, Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimin e mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, si dhe faktin se ky veprim përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pasi subjekti politik LVV ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik LVV ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Prandaj, zhvillimi i fushatës zgjedhore duke përdorur pasuritë publike është në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 36 paragrafi 1, 2 dhe 3 të LZP-së.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë e subjektit politik LVV, por të njëjtat i ka vlerësuar si të pabazuara, për faktin se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe ato të nxjerra nga PZAP sipas nenit 13 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se është shkelur neni 36 paragrafi 1, 2 dhe 3 i LZP-së nga subjekti politik LVV. Nga arsyet e theksuara më lart, duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, nenin 118 paragrafi 1 dhe nenin 120 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin me gjobë të shqiptuar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më 28 dhjetor 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se në mënyrë të drejtë është vërtetuar shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, e paraparë në nenin 36 par.1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme, ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkitazi me shkeljen e supozuar të nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, dënimin me gjobë të shqiptuar dhe interpretimin e PZAP-së



lidhur me përdorimin e pasurisë publike dhe pjesëmarrjen e zyrtarëve publikë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pathemelta dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, vendimin e atakuar e bazon në prova konkrete, të qarta dhe ekzistuese, pasi që gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht nga hulumtimi dhe verifikimi në llogarinë e rrjetit social Facebook, PZAP ka vërtetuar faktin se kandidatët e subjektit politik ankues: Arbërie Nagavci, Hysen Durmishi, Arben Vitia, Albulena Haxhiu dhe Hajrulla Ceko, kanë promovuar aktivitetet e tyre gjatë fushatës zgjedhore, duke shfaqur logon dhe numrin zgjedhor të subjektit politik lëvizja Vetëvendosje, në hapësirat publike, përkatësisht në: Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës si dhe Urën në Mitrovicë.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), se përdorimi i pasurive publike dhe postimet në rrjetet sociale nuk mund të konsiderohen shkelje e nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe se vendimi i PZAP-së tejkalon kufizimet ligjore, duke cenuar të drejtën e kandidatëve për t'u shfaqur publikisht dhe për të komunikuar aktivitetet institucionale. Gjykata Supreme, pas shqyrtimit të provave materiale konstaton se aktivitetet e promovuara në Ministrinë e Arsimit, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe urën në Mitrovicë, si dhe shfaqja e logos dhe numrit zgjedhor të LVV-së, përbëjnë në mënyrë indirekte përdorim të pasurive publike në funksion të përfitimit elektoral.

PZAP drejtë ka konstatuar faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), përkatësisht kandidatët e tij kanë përdorur pasuritë publike në mënyrë që bie ndesh me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke favorizuar promovimin partiak gjatë fushatës zgjedhore. Nga kjo rrjedh se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP, në vendimin e atakuar, se veprimet e kryera nga subjekti politik LVV, respektivisht kandidatët e këtij subjekti në hapësirat publike, duke përfshirë përdorimin e pasurisë publike nga zyrtarët publikë të cilët janë kandidatë nga radhët e këtij subjekti politik gjatë fushatës elektorale, konsiderohen si shkelje të nenit 36 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.


Gjykata refuzon të pabazuara pretendimet ankimore lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga se veprimet e pa kontestueshme të kandidatëve të këtij subjekti politik, me të drejtë janë vlerësuar si shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe



Kandidatët, nga neni 36 par.1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin dispozitë përcaktohet se: *"1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje. 2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik. 3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik."* Për këto arsye pretendimet e ankuesit nuk ishin relevante dhe as me bazë juridike për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për këtë arsye pretendimet e ankuesit në këtë drejtim u refuzuan si të pabazuara.

Gjykatës Supreme i rezulton se përdorimi i pasurive publike ku ata ushtrojnë veprimtari, në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsye e aprovon qëndrimin e PZAP-së lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 nën paragraf 3, të Ligjit Nr.08-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është deri në 50.000 €. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerëson se gjoja e shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 6.000.00 € (gjashtëmijë euro), është i drejtë dhe i ligjshëm, me të cilin vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, përkatësisht jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit Politik, Mbështetësve dhe Kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodin e Mirësjelljes. Në anën tjetër, rezulton se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës, ka marr për bazë të gjitha rrethanat e përcaktuara në legjislationin në fuqi përfshirë këtu shkallën, peshën e shkeljes dhe natyrën e shkeljes.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Kjo për faktin se si të tilla nuk dëshmuuan se



përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakte të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.134/2025, datë 31.12.2025

Kryetar i kolegjit

Faton Bajrami



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTESINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Funëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



Sheji i shkresës _____
Oznaka spisa: 211/2005

Oznaka spisa: 31.12.2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

1. Pasi marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjat në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të nëdërsës, fikut, personit që punon po natë vendit me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni poste ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocaen

2. Pasi marrësi ose anëtarë i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribiteno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Mē _____ 201 _____ nē ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të martesës
Razlog adbijanja prijmca

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

(Te panevojshmeve bjeri vize - nepotrebone precitati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

Numri i shtojcave:
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

AP Property 31.12-2015-

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioea ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analibet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakum pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostaljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Form 12000